

VENDIM I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME
TE SHOQERISE SOFIGAZ sh.p.k. I DATES 30.09.2001



Me 30.09.2001, ne oren 12.00, ne seline e saj ne Tirane, u mbajt Asamblea e Jashtezakonshme shoqerise Sofigaz sh.p.k., e regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranes, me numer vendimi 15470, date 19.07.1996, per te diskutuar e vendosur per rendin e dites si me poshte :

1. Miratimi i bilancit te vitit 2000.
2. Shtimi i kapitalit themeltar.
3. Miratimi i ndryshimeve perkatese ne statutin e shoqerise.
4. Te ndryshme.

Me unanimitet ngarkohet per te mare Presidencen e Asamblese zoti Maurizio Colombo, i cili cakton si sekretar te mbledhjes noterin e qytetit te Tiranes, Agim Robo. Presidenti konstaton dhe ben te ditur se mer pjese i gjithe kapitali themeltar i shoqerise Sofigaz sh.p.k., i perbere nga 2 ortaket, shoqeria Multigas Est srl me 80 pjese te kapitalit, perfaqesuar me autorizim te veçante nga z. Maurizio Colombo dhe z. A. Strazimiri me 20 pjese te kapitalit.

Presidenti i Asamblese lexon rendin e dites dhe fton ortaket te deklarojne ne se kane ndonje verejtje per te filluar diskutimin e pikave te rendit te dites. Te gjithe te pranishmit deklarojne se jane gati te diskutojne, keshtu qe fillon shqyrtimi i pikave te rendit te dites.

Pas nje diskutimi te gjere, Asamblea me unanimitet

v e n d o s i per sa vijon :

1. Per piken e pare te rendit te dites.

Miratohet bilanci i vitit 2000 te shoqerise dhe raporti perkates.

2. Per piken e dyte te rendit te dites.

Miratohet shtimi i kapitalit nga 100.000 leke ne 20.200.000 leke. Ky shtim kapitali kryhet nga ortaku shoqeria Multigas Est srl dhe perfaqeson shtimin ne para te 300.000.000 Lira Italiane, me kursin e fiksuar prej 0.067 leke/lira, behet 20.100.000 leke dhe ne pjese me nga 1.000 leke sejcila behet 20.100 pjese te kapitalit themeltar.

3. Per piken e trete te rendit te dites :

a) Miratimin e ndryshimit te Statutit, neni 7, si me poshte:

Kapitalit themeltar perbehet nga 20.200.000 leke e ndare midis ortakeve si me poshte :

- Multigas Est srl kontribon me shumen 20.180.000 leke.

- Z. A. Strazimiri kontribon me shumen 20.000 leke.

b) Miratimin e ndryshimit te Statutit, neni 8, paragrafi i pare, si me poshte:

- Shoqeria Multigas Est srl mer 20.180 pjese te kapitalit themeltar ose 99.9 % e tij.

- Z. Ardian Strazimiri mer 20 pjese te kapitalit themeltar ose me 0.1 % e tij.

4. Per piken e katert te rendit te dites.


a) Asambleja vendosi qe 10 % te fitimit neto te shoqerise ti akordohet ortakut A. Strazimiri i cili do ta perdore per blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vlere nominale, deri sa te plotesoje, brenda 4 vjeteve, jo me shume se 10 % te krejt kapitalit themeltar.

b) Ngarkohet Administratori i Shoqerise, z. Maurizio Colombo te kryeje te gjitha veprimet ligjore per regjistrimin e ketij vendimi ne organet kompetente.

Duke mos pasur gje tjeter per te vendosur dhe asnje nuk e kerkoi fjalen mbledhja mbyllet ne oren 13.00, mbas leximit dhe neneshkrimit te ketij proces - verbali.

ORTAKET

Per: Multigas Est srl
Maurizio Colombo



Ardian Strazimiri

